

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË
PASTRIMIT TË PARAVE**

**Udhëzues mbi zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare në fushën e luftës
kundër financimit të terrorizmit**

Korrik 2015

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Sistemi i ngrirjes së pasurisë.....	3
Rekomandimi Special III	5
Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.....	5
Rezoluta 1267	5
Rezoluta 1373.	6
Rezoluta 1452	6
Baza ligjore në Republikën e Shqipërisë	7
Detyrimet në zbatim të masave kundër financimit të terrorizmit.....	7
Procesi i ankimimit	9
Procesi i heqjes nga lista.	9
Qasja në fondet dhe pasuritë e tjera.	10

HYRJE

Në përgjigje të rritjes dhe përhapjes së sulmeve terroriste në mbarë botën, komuniteti ndërkombëtar është bashkuar në fushatën për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera të terroristëve dhe atyre që financojnë terrorizmin apo organizatat terroriste.

Në kuadrin e kësaj fushate, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezolutat 1267 (1999) dhe 1373 (2001) ndërkohë që detyrimet ndërkombëtare në këtë fushë, janë pasqyruar gjithashtu në Rekomandimin Special III (R.S III) të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF).

Shënimet shpjeguese RS III përmbajnë një sërë masash për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare për ngrirjen e fondeve dhe pasurive të terroristëve.

Sistemi i ngrirjes së pasurisë

Një sistem efektiv për ngrirjen e fondeve dhe pasurive ka një rëndësi të dorës së parë, për luftën kundër financimit të terrorizmit dhe duhet të synojë të shkojë përtej bllokimit dhe sekuestrimit të fondeve dhe pasurive të tjera, pasi ai ndër të tjera ndikon në:

- (i) frenimin e personave që nuk i janë nënshtruar procesit të shpalljes, të cilët mund të jenë të prirur për të financuar aktivitete terroriste;
- (ii) ekspozimin e burimeve të financimit, që mund të sigurojnë të dhëna për celula të panjohura terroriste dhe financuesit e tyre;
- (iii) çmontimin e rrjeteve të financimit të terrorizmit, duke i inkurajuar personat e shpallur që të distancohen nga aktiviteti terrorist dhe të heqin dorë nga përkatësia e tyre në grupe terroriste;
- (iv) ndërprerjen e flukseve monetare të terroristëve, duke siguruar mbylljen kanaleve të përdorura për të transferuar fondet apo pasuri të tjera të lidhura me terrorizmin;
- (v) detyrimin e terroristëve për të përdorur mënyra më të kushtueshme për të financuar aktivitetet e tyre, gjë që e lehtëson zbulimin dhe goditjen e tyre;

Ky udhëzues i hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave i vjen kryesisht, në ndihmë sektorit financiar për shkak të rrezikut të lartë të financimit të terrorizmit ndaj të cilit ai është i ekspozuar si dhe nevojës së veçantë të këtij sektori për komunikim dhe udhëzime në lidhje me ngrirjen e fondeve të personave të shpallur apo të dyshuar për përfshirje në aktivitete terroriste.

Pavarësisht kësaj, në nivel ndërkombëtar kërkesat e këtij sistemi, shtrihen tek të gjithë personat dhe subjektet që janë të detyruar të ngrijnë fondet ose pasuritë e tjera të personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB 1267 (1999) 1373 (2001), si dhe çdo rezolute të miratuar në vijim të tyre.

Mangësitë në ngrirjen e shpejtë dhe efektive të fondeve dhe pasurive të personave të shpallur si terroristë apo në proces shpallje kanë një efekt negativ në përpjekjet që ndërmarrin vendet dhe komuniteti ndërkombëtar për të luftuar financimin e terrorizmit.

Në përcaktimin e kufijve të një rregjimi efektiv kundër financimit të terrorizmit, vëndet duhet të sigurojnë gjithashtu respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe njohjen e të drejtave të palëve të interesuara.

Natyra globale e rrjeteve të financimit të terrorizmit dhe urgjenca në përgjigjen kundër kërcënimeve terroriste, gjithashtu diktojnë nevojën e komunikimit dhe bashkëpunimit brënda dhe mes qeverive si dhe mes sektorit publik dhe atij privat. Është i njohur fakti se vende të ndryshme kanë krijuar sisteme të ndryshme të ngrirjes së fondeve dhe pasurive të terroristëve, në përputhje me traditat e tyre ligjore, kërkesat kushtetuese, sistemet e qeverisjes dhe potencialet teknologjike.

Shpërndarja e shpejtë dhe efikase e informacioneve mbi financimin e terrorizmit për të gjithë ata që mund të ndihmojë në identifikimin, pengimin dhe shpërbërjen e rrjeteve të financimit të terrorizmit, është në qëndër të përpjekjeve ndërkombëtare për të ngrirë fondet apo pasuritë e tjera të terroristëve. Mbështetja dhe angazhimi aktiv në këtë proces i sektorit privat përbën një element thelbësor për të siguruar suksesin e çdo sistemi të ngrirjes.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tyre në nivel ndërkombëtar për ngrirjen e fondeve, vëndet hartojnë procedurat e nevojshme ligjore si dhe përcaktojnë autoritetet kompetente apo gjykatat përgjegjëse për:

- (a) ngrirjen e fondeve apo pasurive të tjera të personave të shpallur;
- (b) pezullimin e masave të ngrirjes;
- (c) të siguruar në rrethana të caktuara kryerjen e shpenzimeve nga fondet e ngrira.

Disa nga praktikat më të mira që vëndet përdorin në këtë proces janë:

i) Hartimi i një procesi të shpalljes, sipas të cilit një autoritet kompetent ose një gjykatë autorizohet për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera, të bazuara në informata mbi të cilat krijohen baza të arsyeshme, për të dyshuar apo besuar se këto fonde ose pasuri të tjera janë të lidhura me terroristët. Për këtë qëllim vëndet mund të miratojnë procedura ekzekutive, administrative ose gjyqësore, me kusht që:

- (a) një autoritet kompetent ose gjykata është në gjëndje të përcaktojë në mënyrë të menjëhershme nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ose një bazë e arsyeshme për të dyshuar apo të besuar se një person apo entitet është një terrorist, organizatë terroriste apo person që ka lidhje me terroristët;
- (b) fondet ose pasuritë e tjera që lidhen me terrorizmin i nënshtrohen menjëherë procesit të ngrirjes pas konstatimit se ekzistojnë baza të tilla të arsyeshme;
- (c) ngrirja e fondeve dhe pasurive të tjera kryhet pa njoftimin paraprak të palëve të përfshira;

Këto procedura mund të plotësojnë mekanizma ligjor ekzistues për sekuestrimin dhe konfiskimin civil ose penal.

ii) Përcaktimin e procedurave efektive për të lehtësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet agjencive përkatëse shtetërore dhe subjekteve, gjatë procesit të shpalljes në mënyrë që të:

(a) të sigurojë të gjitha informatat në dispozicion për të identifikuar me saktësi personin e shpallur (p.sh. data e lindjes, adresa, shtetësia ose numrin e pasaportës të individëve; vende, data dhe vendi i krijimit të shoqërisë, për personat juridik

(b) të shqyrtojë dhe bashkërendojë, sipas rastit, çdo shpallje në përputhje me alternativat dhe veprimet që mund të ndërmerren kundrejt terroristëve, organizatave terroriste dhe personat e lidhur me ta

iii) Projektimin e një procesi për institucionet financiare për të informuar organet kompetente ose gjykatat në lidhje me fondet apo pasuritë e ngrira (emrat, llogaritë, shumat).

Rekomandimi Special III

Rekomandimi Special III i FATF, përbëhet nga dy detyrimeve themelore. Detyrimi i parë kërkon që vendet të zbatojnë masat për ngrirjen pa vonesë dhe në se është e përshtatshme, sekuestrimin e fondeve dhe pasurive që lidhen me terroristët në pajtim me rezolutat përkatëse të Kombeve të Bashkuara. Detyrimi i dytë kërkon që vendet të kenë në dispozicion mekanizmat për të sekuestruar dhe konfiskuar fondet apo pasuritë e terroristëve, në bazë të një urdhëri të lëshuar nga një autoritet kompetent ose gjykatë. Në këtë rast synohet që terroristët të privohen nga fondet apo pasurit e tjera.

Qëllimi i detyrimit të parë është parandalues, ndërsa qëllimi i të dytit është kryesisht parandaluese dhe ndëshkues. Të dy kërkesat janë të nevojshme për të privuar terroristët dhe rrjetet terroriste nga instrumentet e nevojshëm për të kryer akte të mëtejshme apo për të mbështetur infrastrukturën dhe operacionet e tyre.

Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Rezoluta 1267

Rezoluta 1267 është miratuar në tetor 1999, në vazhden e rezolutave të mëparshme që kishin të bënin me gjëndjen në Afganistan. Ajo rikonfirmon angazhimin e OKB ndaj sovranitetit, pavarësisë, integritetit territorial dhe unitetit kombëtar të këtij vendi si dhe respektin për trashëgiminë e tij kulturore dhe historike.

Rezoluta gjithashtu vë theksin në shqetësimin për rritjen e shkeljes së të drejtave të njeriut, prodhimit të lëndëve narkotike, përdorimit të territorit të kontrolluar nga Talibanët për trajnimin e terroristëve¹ (veçanërisht të Usama Bin Laden) dhe kryerjen e akteve terroriste në nivel ndërkombëtar.

Në funksion të zbatimit të kësaj rezolutë është krijuar komiteti 1267, i cili merr në konsideratë kërkesat që paraqiten nga vendet anëtare për listimin e personave të lidhur me terrorizmit apo financimin e tij, ankesat në lidhje me listimin apo bllokimin e fondeve dhe pasurive të tjera të personave të shpallur, si dhe raportet e vendeve anëtare në drejtim të zbatimit të saj.

¹ Veçanërisht të Usama Bin Laden duke kërkuar dhe dorëzimin e tij.

Kërkesa kryesore për vendet anëtare në kontekstin e kësaj rezolute është ngrirja pa vonesë e fondeve² dhe pasurive të tjera të Talibanëve, përfshirë këtu dhe të ardhurat e siguruara nga pasuri në pronësinë e tyre direkte apo indirekte si dhe të ndërmarrin masa kundër atyre që shkelin këtë kërkesë.

Të dhëna të detajuara në lidhje me përditësimet që i bëhen në vijimësi listës së OKB mund të merren në faqet në vijim

http://www.un.org/sc/committees/1267/aq_sanctions_list.shtml.

www.fint.gov.al

Rezoluta 1373.

Rezoluta 1373 është miratuar në shtator 2001 dhe disa nga detyrimet kryesore që ajo parashikon për vendet anëtare të OKB janë:

- Të parandalojnë dhe ndëshkojnë financimin e akteve terroriste;
- Të dënojnë sigurimin ose mbledhjen e fondeve nga shtetasit e tyre apo në territorin e tyre për kryerjen e akteve terroriste;
- Të sigurojnë ngrirjen pa vonesë të fondeve dhe pasurive të tjera financiare të personave që kryejnë ose sigurojnë mbështetje në kryerjen e akteve terroriste;
- Rezoluta 1373 (2001) gjithashtu ju ndalon të gjithë personave fizikë dhe juridikë të një vendi, të japin çfarëdolloj shërbimesh financiare apo ndonjë formë tjetër mbështetje për personat e shpallur;
- Të parandalojnë nëpërmjet kontrolleve efektive të kufirit, lëvizjen e terroristëve ose grupeve terroriste;
- Të përshpejtojnë dhe intensifikojnë shkëmbimin e informacionit për çështjet e financimit të terrorizmit;

Në zbatim të kësaj rezolute, kërkohet që vendet gjithashtu t'i japin njëri tjetrit ndihmesën e duhur në lidhje me hetimet e krimeve ose të procedimeve penale, që lidhen me financimin ose mbështetjen e akteve terroriste;

Rezoluta 1452

Rezoluta 1452, është miratuar në dhjetor 2002 dhe përcakton një sërë përjashtimesh që vendet mund të bëjnë për sa i përket të drejtës për të përdorur fondet e sekuestruara në zbatim të rezolutës 1267, duke marrë në konsideratë krijimin e një procesi objektiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbulimin e shpenzimeve themelore dhe të jashtëzakonshme të duke përcaktuar njëkohësisht dhe detyrimin që vendet anëtare të komunikojnë dhe të kërkojnë prej Kombeve të Bashkuara miratimin për këtë qëllim.

² Kërkesa për ngrirjen e fondeve ripërsëritet në Rezolutën 1333 (2000) të Këshillit të Sigurimit të OKB.

Baza ligjore në Republikën e Shqipërisë

Procesi i ngrirjes së fondeve dhe pasurive të terroristëve apo personave të lidhur me terrorizmin, bazohet në ligjin nr.157 dt.10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe goditja e veprimtarive të terroristëve dhe e atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, apo të atyre, për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, nëpërmjet bllokimit, sekuestrimit të fondeve e pasurive të tyre, në zbatim të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Termat që kanë të bëjnë me bllokimin e përkohshëm, sekuestrimin, terrorist, person që financojnë terrorizmin, person i shpallur dhe person i interesuar janë në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare në këtë fushë dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e mekanizmave të parashikuar për shpalljen e personave, listimin e tyre në vendimet e Këshillit të Ministrave, bllokimin e fondeve dhe pasurive të identifikuar, bashkëpunimin dhe koordinimin mes autoriteteve përgjegjëse përfshirë këtu dhe shkëmbimin e informacionit.

Detyrimet në zbatim të masave kundër financimit të terrorizmit

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë detyrime të qarta për sa i përket përfshirjes në listën e personave të shpallur, masave për fondet dhe pasuritë e tjera, organet përgjegjëse për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit, mbledhjen dhe administrimin e të dhënave, shkëmbimin e të dhënave, detyrimin për raportim, procedurat e shpalljes, bllokimin e përkohshëm apo sekuestrimin e fondeve dhe pasurive të tjera, shpenzimet e lejuara nga fondet dhe pasuritë e tjera, kundërvajtjet administrative dhe procesin e mbikëqyrjes së përputshmërisë.

Detyrimin për raportimin e të dhënave për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste e mbart çdo person përfshirë këtu dhe subjektet e përcaktuara në ligjin nr.9917 dt.19.05.2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*” i ndryshuar.

Raportimi në fjalë duhet të përmbajë të dhëna për identifikimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të dhëna për pronësinë dhe interesa të tjerë rreth tyre, si dhe shpjegime për motivet ku mbështeten të dhënat e arsyeshme për financimin e terrorizmit.


Procesi i ngrirjes së fondeve dhe pasurive të tjera

Neni 22 i ligjit “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*” përcakton modalitetet e sekuestrimit të fondeve dhe pasurive në bazë të urdhërit të sekuestrimit të nxjerrë nga Ministri i Financave në funksion të

zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për personat e shpallur sipas kërkesave të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Urdhri i Ministrisë ka efekt të menjëhershëm dhe i komunikohet personit të shpallur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe ju dërgohet njëkohësisht Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe institucioneve, subjekteve e organeve përgjegjëse, në të cilat janë evidentuar fonde dhe pasuri të tjera, të cilat marrin masa për ekzekutimin e menjëhershëm të tij.

Në vijim paraqitet në mënyrë grafike sistemi Shqiptar i shpalljes së personave të përfshirë në financimin e terrorizmit si dhe procesi i ngrirjes së fondeve dhe pasurive të tjera, të bazuar në ligjin “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.



Procesi i ankimimit

Siç është përmendur më lartë respektimi i të drejtave të njëriut është një pjesë integrale e çdo sistemi të ngrirjes së fondeve dhe pasurive të personave të shpallur, përfshirë këtu dhe personat e lidhur me ta.

Në këtë kuadër nenet 17 “*Ankimi kundër bllokimit të përkohshëm*” dhe 19 “*Ankimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave*”, të ligjit “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*” kanë parashikuar një mekanizëm të qartë të ankimimit të urdhërit të bllokimit të përkohshëm të Ministrit të Financave si dhe listimit të personit të shpallur, me vendim të Këshillit të Ministrave...

Në rastin e ankimimit kundër bllokimit të përkohshëm personi i interesuar ka detyrimin që të provojë përpara gjykatës se:

- a) ka një të drejtë të ligjshme në fondet dhe pasuritë e tjera të personit, të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Financave;
- b) ka burime të justifikuara ligjërisht për të drejtat dhe interesat e tij në fondet dhe pasuritë e tjera;
- c) fondet dhe pasuritë e tjera, objekt gjykimi, nuk kanë lidhje me terroristë, persona që financojnë terrorizmin ose persona të tjerë të lidhur me ta

Në të dy rastet ankimimi bëhet në gjykatën kompetente, sipas afatave dhe procedurave të gjykimeve administrative.

Procesi i heqjes nga lista.

Neni 25 “*Ndryshimi dhe revokimi i vendimit për personat e shpallur*” i ligjit “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*” përcakton mënyrën e heqjes nga lista të personave të shpallur e cila bëhet në rastet kur vërtetohen rrethanat e mëposhtme

- për shkak të një vendimi të mëvonshëm të strukturave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji;
- për shkak të një detyrimi që i kërkohet ose i lind Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 25 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
- për shkak të një vendimi përkatës të organizatave të tjera ndërkombëtare, të Bashkimit Europian ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- për shkak të vendimit të heqjes nga lista të personit nga vendi që ka kërkuar shpalljen;
- për shkak të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente, të marrë pas ankimit të personit të shpallur, sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 19 të këtij ligji;
- kur kanë ndryshuar rrethanat, faktet dhe arsyet, për të cilat është bërë shpallja, sipas nenin 15 të këtij ligji.

të cilat e bëjnë të panevojshme zbatimin ndaj tyre të masave kundër financimit të terrorizmit.

Qasja në fondet dhe pasuritë e tjera.

Bazuar në nenin 23, të ligjit “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, Ministri i Financave ka miratuar Udhëzimin nr.1 dt.16.01.2014 “*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të shpallur*” i cili pasqyron të drejtat dhe shpenzimet që kanë personat e shpallur për sa ju përkete fondeve dhe pasurive të sekuestruara.

Kategorizimi i shpenzimeve të lejuara, në themelore dhe të jashtëzakonshme është bërë mbi bazën e Rezolutës 1452, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe synon që të krijojë kushtet për mbulimin e shpenzimeve për ushqim, barna dhe trajtime mjekësore, pagesën e qerasë apo hipotekës si dhe detyrime të tjera që shkaktohen nga forca madhore.

Neni 4 i këtij udhëzimi, përcakton hapat që kërkuesi duhet t'i paraqesë ministrit të Financave të shoqëruar me pretendimet mbi fondet e sekuestruara si dhe dokumentacionin justifikuar për sa i përket vlerëse dhe mënyrës së përdorimit të fondeve të kërkuara. Shqyrtimi i kërkesës bëhet në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.